

RELACION

PËR

PROJEKTLIGJIN “PËR DISA SHITESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR.64/2012, DATË 31.5.2012 “PËR PESHKIMIN”, TË NDRYSHUAR”

I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Ky projektligj ka për qëllim dhe mundëson rregullimin e peshkimit bregdetar artizanal në kuadër të bashkëmenaxhimit me organizatat e peshkimit, për një qasje më të afërt me fusha të rëndësishme të politikës së përbashkët të peshkimit të Bashkimit Evropian, dokumentit programatik të Unionit për mbështetjen dhe zhvillimin e sektorit të peshkimit. Projektligji jep përcaktimin e saktë të organizatave të peshkimit, funksionin dhe objektivat e tyre si dhe format apo mënyrat dhe kriteret e ndryshme të menaxhimit të infrastrukturës së peshkimit.

Objektiv i rëndësishëm i këtij projektligji është përcaktimi i parimeve mbi të cilat mbështetet dhe kushteve që duhet të plotësojnë organizatat e peshkimit për menaxhimin dhe mirëmbajtjen e infrastrukturës së peshkimit të transferuar për menaxhim prej tyre. Në projektligj riformulohen më qartë disa përkufizime si dhe përcaktohen detyrat e institucionit përgjegjës për shërbimet e peshkimit dhe të akuakulturës.”.

II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE

Ky projektligj është në përputhje dhe në zbatim të programit politik të qeverisë për zhvillimin e sektorit të peshkimit dhe, në mënyrë të veçantë, për peshkimin bregdetar artizanal, prandaj miratimi i tij është shumë i rëndësishëm.

III. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME

Mënyra e organizimit të organizatave prodhuese në ligjin aktual bazohet në rregulloren (KE) nr.104/2000, e cila është shfuqizuar nga rregullorja e Këshillit nr.1379/2013/KE, datë 11 dhjetor 2013, në lidhje me organizimin e përbashkët të tregjeve të prodhimeve të peshkimit dhe akuakulturës. Ndryshimet e propozuara bazohen në rregulloren nr.1379/2013/KE, datë 11 dhjetor 2013.

Bazuar në konceptin e organizatave të peshkimit është parashikuar rregullimi i peshkimit bregdetar artizanal sipas eksperiencës së vendeve mesdhetare, anëtare të BE-së (Itali, Kroaci etj.).

Subjektet që ushtrojnë peshkim bregdetar artizanal me mjet lundrues, me qëllim që të kenë të drejtë të hyjnë në burime, do të përfshihen në organizata menaxhimi të peshkimit artizanal bregdetar në nivel qarku apo në forma organizimi më të mëdha.

Gjithashtu, në kuadër të bashkëmenaxhimit nëpërmjet organizatave të peshkimit, që duhet të ngrihen në këto zona peshkimi, ky rregullim do të bëjë të mundur disiplinimin e këtij aktiviteti, kontrollin më efikas, për të shmangur peshkimin PPP (të paligjshëm, të paraportuar dhe të parregulluar), raportimin e saktë të zënieve të peshkut, ruajtjen më të mirë të resurseve, përmirësimin e kushteve higjieno – sanitare të tregtimit dhe transportit të peshkut të zënë, rritjen e gjurmueshmërisë së produkteve të peshkimit, me qëllimin për një qasje dhe informacion më të qartë e të plotë të konsumatorit për këto produkte.

Ky projektligj përcakton format, mënyrat dhe kriteret për menaxhimin e infrastrukturës portuale, si dhe bën përcaktimin e parimeve mbi të cilat mbështetet dhe të kushteve që duhet të plotësojë organizata e peshkimit për menaxhimin dhe mirëmbajtjen e infrastrukturës së peshkimit të transferuar.

Projektligji bën të mundur unifikimin e disa termave dhe, konkretisht, peshkimin tregtar artizanal ose peshkimin bregdetar artizanal, të cilët përdoren shpesh në nivel kombëtar dhe/ose ndërkombëtar apo një saktësim më të qartë se çfarë është sistemi monitorues i anijeve të peshkimit.

Projektligji përcakton se e drejta e peshkimit bregdetar artizanal pa mjet lundrues fitohet nëpërmjet konkurrimit publik. Këto aktivitete kanë qenë të pambuluara nga legjislacioni, i cili parashikon që peshkimi detar dhe bregdetar kryhet me mjete lundruese dhe, si i tillë, lejimi i aktivitetit të peshkimit bëhet nëpërmjet QKB-së. Por, ka një numër aktivitete, si grumbullimi i molusqeve dykapakorëve etj., që zhvillohen në bregdet pa mjete lundruese, të cilat duhet t'i nënshtrohen konkurrimit publik. Gjithashtu, projektligji përcakton përgjegjësitë që ka institucioni përgjegjës për shërbimet e peshkimit dhe të akuakulturës, si administratore e infrastrukturës portuale dhe e qendrave të ripopullimit të kategorive ujore, në pronësi dhe varësi të MBZHR-së.

IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI, VENDAS E NDËRKOMBËTAR

Ky projektligj është në përputhje me Kushtetutën, me legjislacionin përkatës, që rregullon këtë fushë në vendet anëtare të BE-së, si dhe me politikën e përbashkët të peshkimit (Common Fisheries Policy).

V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME ACQUIS E BE (PËR PROJEKTAKTET NORMATIVE)

Ky projektligj përafron pjesërisht me:

- Rregulloren e Këshillit nr.1379/2013/BE, datë 11 dhjetor 2013, në lidhje me organizimin e përbashkët të tregjeve të prodhimeve të peshkimit dhe akuakulturës, që amendon rregulloret nr.1184/2006/(KE) dhe nr.1224/2009/KE, si dhe shfuqizon rregulloren (KE) nr.104/2000 të Këshillit.

- Rregulloren e Këshillit nr.508/2014/BE, datë 15 maj 2014, mbi Fondin Evropian Detar dhe të Peshkimit, që shfuqizon rregulloret e Këshillit (KE) nr.2328/2003, (KE) nr.861/2006, (KE) nr.1198/2006 dhe (KE) nr.791/2007 dhe rregulloren (BE) nr.1255/2011 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit.

Gjithashtu ky projektligj merr parasysh edhe rekomandimet e KE-së, të shprehura në progres raportet e viteve 2013 – 2016 (Kapitulli 13 “Peshkimi”).

VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Në nenin 1 përcaktohet se kudo në përmbajtje të ligjit emërtimi “Drejtoria e Shërbimeve të Peshkimit dhe Akuakultures” zëvendësohet me “Institucioni përgjegjës për shërbimet e peshkimit dhe të akuakulturës”. Sqarojmë se ky ndryshim nuk do të sjellë ndryshim në strukturën apo mënyrën e funksionimit aktual të DSHPA-së, pasi institucioni përgjegjës për shërbimet e peshkimit dhe të akuakulturës do të vazhdojë të funksionojë si institucion në varësi të ministrisë, organizimi dhe funksionimi i të cilit është përcaktuar me vendim të Këshillit të Ministrave.

Në nenin 2 jepen përcaktimet e termave “Peshkim tregtar artizanal ose peshkim bregdetar artizanal” sipas rregullores së Këshillit nr.508/2014/KE, datë 15 maj 2014, mbi Fondin Evropian Detar dhe të Peshkimit, “Sistemi i monitorimit të anijeve”, me qëllim që të shmangen keqkuptimet e deritanishme nëse sistemi përfshin vetëm pajisjet *hardware & software* ose vetëm pajisjet MTU (*Mobile Transceiver Unit*), apo të dyja pajisjet krijojnë një sistem të vetëm, si dhe përkufizimi i “peshkimi pa mjete lundruese”.

Në nenin 3 është bërë një shtesë dhe saktësim i mëtejshëm, pasi ligji parashikon, jo vetëm lëshimin e lejeve, por edhe të së drejtës së peshkimit.

Neni 4 përcakton se e drejta e peshkimit bregdetar artizanal, pa mjet lundrues, fitohet nëpërmjet konkurrimit publik. Kjo shtesë (pika 7, e nenit 30) bëhet pasi ka disa forma të peshkimit artizanal, si grumbullim organizmash ujore apo

molusqesh, peshkim me bilance apo stavnike, që zhvillohen pa mjete lundruese në sipërfaqe të ndryshme detare.

Neni 5 përcakton format dhe mënyrën e organizimit që duhet të plotësojnë subjektet apo anijet e peshkimit bregdetar artizanal për të fituar të drejtën për të hyrë në burime, pra për të peshkuar. Zotërimi në pronësi apo përdorim i një mjeti lundrues nuk është kushti i vetëm dhe i mjaftueshëm për të fituar të drejtën për të hyrë në burime.

Në nenin 6 përcaktohen mjetet që përdoren për peshkim çlodhës-argëtues si dhe mënyra e lëshimit të autorizimit. Ky ndryshim është vetëm një saktësim.

Neni 7 zgjeron fushat e veprimtarisë së organizatave të menaxhimit të peshkimit, nisur nga eksperiencia më e mirë e menaxhimit të zonave bashkëmenaxhuese e simotrave të tyre në liqenet e Shkodrës dhe Ohrit apo dhe nga eksperiencia e vendeve fqinje.

Në nenin 8 jepet riformulimi i organizatave të prodhuesve në peshkim, bazuar edhe në rregulloren e Këshillit nr.1379/2013/BE.

Neni 9 përmban shtesën në dy nene të veçanta, për sa u përket objektivave të organizatave të prodhuesve (neni 61/1) dhe objektivave të organizatave të peshkimit bregdetar artizanal (neni 61/2). Objektivat e organizatave të peshkimit janë në përputhje me Strategjinë Kombëtare të Peshkimit dhe synojnë ushtrimin e aktivitetit fitimprurës e të qëndrueshëm, disiplinimin e këtij aktiviteti, kontrollin më efikas për të shmangur peshkimin PPP (të paligjshëm, të paraportuar dhe të parregulluar), raportimin e saktë të zënieve të peshkut, ruajtjen më të mirë të resurseve, përmirësimin e kushteve higjieno – sanitare të tregtimit dhe transportit të peshkut të zënë, rritjen e gjurmueshmërisë së produkteve të peshkimit, me qëllim një qasje dhe informacion më të qartë e të plotë të konsumatorit për këto produkte.

Neni 10 riformulon mënyrat, kushtet dhe kriteret për menaxhimin e infrastrukturës së peshkimit nga ana e një organizate peshkimi.

Në nenin 11 përcaktohen mënyrat se si institucioni përgjegjës për shërbimet e peshkimit dhe të akuakulturës menaxhon infrastrukturën e peshkimit si dhe parimet sipas të cilave një organizatë peshkimi menaxhon infrastrukturën e transferuar.

Neni 12 riformulon detyrat dhe fushën e përgjegjësisë së institucionit përgjegjës për shërbimet e peshkimit dhe të akuakulturës. Sipas përcaktimit ligjor, ky institucion menaxhon infrastrukturën e peshkimit dhe qendrat e ripopullimit të kategorive ujore në varësi të ministrisë, pra duke u marrë me menaxhimin e aseteve të peshkimit. Këto ndryshime në lidhje me detyrat dhe fushën e përgjegjësisë së institucionit përgjegjës për shërbimet e peshkimit dhe të

akuakulturës bëjnë një riorganizim të detyrave të saj, në kuadër të ndryshimeve që ka pësuar më parë ligji nr.64/2012, “Për peshkimin”, i ndryshuar, duke i lënë këtij institucioni vetëm kompetencat për menaxhimin e aseteve të peshkimit. Gjithashtu, ky ndryshim në emërtim nuk prek numrin e punonjësve dhe nuk ka efekte shtesë në buxhet.

Neni 13 riformulon nenin 135 të ligjit, duke ndryshuar përcaktimet e akteve nënligjore që nxjerr Këshilli i Ministrave dhe ministri, në përputhje me ndryshimet e bëra në këtë projektligj.

Në zbatim të ligjit nr.146/2014, “Për njoftimin dhe konsultimin publik”, ky projektligj i është nënshtruar procesit të njoftimit dhe konsultimit publik nëpërmjet publikimit në regjistrin elektronik (RENJK). Gjatë periudhës së pritjes së komenteve, sipas afatit të përcaktuar në ligji, nuk pati asnjë koment apo sugjerim.

VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E PROJEKTAKTIT

Për zbatimin e këtij projektligji ngarkohet Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe institucioni përgjegjës për shërbimet e peshkimit dhe të akuakulturës.

VIII. PERSONAT DHE INSTITUCIONET QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT

Ky projektligj u përgatit nga grupi i punës i MBZHR-së, i ngritur me urdhrin nr.138, datë 30.3.2018, të ministrit.

IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

Ky projektligj nuk shoqërohet me efekte financiare në buxhetin e shtetit, dhe riemërimi i “Drejtorisë së Shërbimeve të Peshkimit dhe Akuakulturës” në “Institucioni përgjegjës për shërbimet e peshkimit dhe të akuakulturës” nuk do të shoqërohet me efekte financiare shtesë.

KËSHILLI I MINISTRAVE